



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:144342

Datë: 18.11.2024

Numri i dokumentit: 06464253

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Dardan Maloku, në çështjen penale ndaj të pandehurit S.K, me vendbanim në Rr. "M.K", fshati D..., komuna K..., duke vendosur lidhur me marrëveshjen e ndërmjetësimit me nr. ND. 152/24, të datës 14.11.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit S.K, në një të anë dhe të dëmtuarit F.H, në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 174/23 e datës 26.06.2023, për shkak të veprës penale Vetëgjyqësia neni 410 paragrafi 1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK), në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale (tani e tutje KPP) dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seance, më datë 18.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I.** **APROVOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr.152/2024, e datës 14.11.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, në mes të pandehurit S.K, me vendbanim në Rr. "M.K", fshati D..., komuna K..., i lindur me datë ..., me numër personal ..., në një të anë dhe të dëmtuarit F.H, në anën tjetër.
- II.** **Hudhet** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.174/23 e datës 26.06.2023, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit S.K, për shkak të veprës penale Vetëgjyqësia neni 410 paragrafi 1 të KPRK-së.
- III.** Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.174/23, të datës 26.06.2023, e ka akuzuar të pandehurin S.K, për veprën penale Vetëgjyqësia nga neni 410 paragrafi 1 të KPRK-së.

Më datë 14.11.2024, është mbajtur shqyrtimi gjyqësor dhe në këtë shqyrtim bazuar në nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim palët kanë propozuar që kjo çështje penale të zgjidhet përmes procedurës së ndërmjetësimit. Gjykata e ka aprovuar propozimin e palëve dhe bazuar në nenin 229 paragrafi 1 të KPP-së, e ka referuar çështjen në ndërmjetësim.

Më datë 14.11.2024 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr. 152/2024, në mes të pandehurit S.K, me vendbanim në Rr. “M.K”, fshati D..., komuna K..., i lindur me datë ..., me numër personal ..., në njërën anë dhe të dëmtuarit F.H, në anën tjetër.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim KPP-në dhe me Ligjin për Ndërmjetësim, dhe kjo marrëveshje do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv. Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga të gjitha të lartcekurat, e në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

2023:144343, datë 18.11.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.